



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 336/1 Prot.

Tiranë, më 26.02.2026

V E N D I M

Nr. 44, datë 26.02.2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 45 Regj., datë 11.02.2026, të shtetases M. D, kundër Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të: “gjendjes shoqërore, përgjegjësisë prindërore, përkatësisë prindërore, aftësisë së kufizuar dhe çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, znj. M. D, pranë KMD-së, ndër të tjera, evidentohet si më poshtë vijon:

M. D ka përfunduar arsimin e lartë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në degën “Gjuhë Italiane”, dhe ka fituar titullin “Mësues i Gjuhës Italiane për Shkollën e Mesme”. Ky fakt provohet nëpërmjet Diplomës Nr. 6141-B, datë 05.07.2008. Ushtron profesionin e mësueses që prej vitit 2009. Në pozicionin aktual – mësuese e lëndës “Gjuhë Italiane” pranë shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi” – emëruar me Vendimin Nr. 45, datë 04.12.2015 (nr. 221 prot., datë 04.12.2015).

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Në vitin 2021, ka fituar Kategorinë e II – “Mësues Specialist” për lëndën “Gjuhë Italiane AMU”, e vërtetuar me Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Sipas certifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 1, Bashkia Tiranë, rezulton me gjendje civile e divorcuar dhe kryefamiljare, nënë e vetme.

Eshte nëna e një djali të mitur, D.D, i datëlindjes 29.07.2013, nxënës në klasën e pestë në të njëjtën shkollë ku punonte. Djali i saj është fëmijë me aftësi të kufizuar të dokumentuar, me diagnozën: Diagnoza 1: xxx - Diagnoza 2: yyy

Këto diagnoza janë përcaktuar zyrtarisht në Vendimin për përcaktimin e aftësisë së kufizuar për të miturin, lëshuar nga Zyra Rajonale e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, më datë 01.10.2024, me vlefshmëri nga 01.10.2024 deri më 01.10.2026.

Subjekti ankues ka pretenduar se, në mënyrë të paqartë dhe në kundërshtim me procedurën ligjore, janë ngritur komisione etike e disipline edhe me parë dhe situata aktuale, pra marrja e masave disiplinore dhe me pas vendimi i largimit janë pasojat e një sjellje vijuese dhe me synimin e qartë atë të largimit nga puna. Ankuesja ka pretenduar se të gjitha këto veprime të padrejta karshi saj, kanë ardhur si pasojë e hakmarrjes për shkak të ankimit të mëparshëm të saj për diskriminim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Konkretisht citojmë ndër të tjera, se ankuesja, veprimet e pretenduara i lidh, me data konkrete, duke u shprehur, si vijon:

“Në datën 07.04.2025 M. D ka marrë një njoftim me anë të emailit ku i bëhej me dije se kundrejt mësueses M.D janë paraqitur ankesa dhe ka filluar procedurë Komisioni i Etikës. Subjektet ankues ishin, së pari, mësuesi i fëmijës së paditëses, për të cilin kjo e fundit kishte shprehur më herët pakënaqësi lidhur me mënyrën e hartimit dhe vlerësimit të testit të djalit të saj me vështirësi zhvillimore – pra, në cilësinë e prindit, dhe jo të punonjësës.

Së dyti, një tjetër subjekt ankues ishte znj. O. T, një prind që më parë kishte sulmuar publikisht paditësen, duke ngritur akuza të pavërteta në drejtim të saj.

Në datën 18.04.2025 që ishte njoftuar se do të mbahej seanca dhe në kushtet kur nuk ishin njoftuar asnjë akt, ankesë apo prova që kishin lidhje me këtë procedurë, në datën 17.04.2025, pra një ditë para se të zhvillohej seanca, M. D ka paraqitur një kërkesë që të përfaqësohej nga avokatët e zgjedhur prej saj, ku për të patur një proces të rregullt administrativ, kërkoi të shtyhej seanca e asaj date, t’i vendoseshin në dispozicion aktet e dosjes që të njëjtit me to dhe të mbante qëndrimin e saj dhe të kryhej dhe ballafaqimi me palët ankuese që ishin profesori E. Ç dhe prindi O. T. Ajo që vihet re nga ana e Komisionit të Etikës është që nuk u pranua kjo kërkesë me argumentin se nuk kishin kohë që të bënin aktet, ndërkohë rezulton se kishin kohë të njoftonin subjektin ankues prindin O. T, që mësuese M. D për të cilën ajo kishte bërë ankesë kishte depozituar këtë kërkesë dhe se do të përfaqësohej me avokat.

Kjo tregon që ky komision nuk ka patur një qëllim objektiv por janë nisur nga qëllime subjektive. Ajo që rezultoi në atë seancë ishte e kundërta, mesuese M. D u bë pjesë e seancës pa ditur me parë se cilat ishin arsyet/ankesa dhe provat e saj që ky komision e kishte thirrur. Gjatë zhvillimit të seancës, është ndërprerë vazhdimisht në mënyrë të njëanshme, duke i mohuar të drejtën për të shprehur qartë versionin e saj dhe për të mbrojtur veten. (procesverbali i KE 18.04.2025)

Pas kësaj seance i behet me dije se ajo mund të paraqiste prapësimet e saj dhe se do ti jepeshin provat ose të shtunën, me datë 19 prill ose më datë 21.04.2025, prova të cilat nuk ju dhanë as në këto data.

Pasi u depozitua prokura më datë 24.04.2025, ka marrë në dorzim dhe 2 ankesa të tjera të mësuesit E. Ç dhe një relacion datë 17.03.2025 nga SHPS, për të cilat nuk kishte patur dijeni më parë.

Në datën 28.04.2025 ora 11:30 i janë paraqitur Komisionit të Etikës prapësimet për çdo ankesë dhe provat për secilin subjekt ankues, konkretisht i janë dorëzuar drejtueses së Komisionit të Etikës. Në e-mailin shoqërues ka bërë me dije dhe mosprezencën e saj sepse i kishte vënë në dijeni si staf drejtues që të hënën kishte terapinë e djalit. (përsëri kjo gjë nuk u mor parasysh nga ana e Komisionit të Etikës dhe u vijua me vendimarrjen e tyre.)

Pa kaluar shumë kohë po në datën 28.04.2025 i është komunikuar me e-mail propozimi i Komisionit të Etikës për masën “Paralajmerim për largim nga puna”.

Pas këtij propozimi do të mblidhej Komisioni i Disiplinës, i cili do të shqyrtonte propozimin e Komisionit të Etikës.

Më datë 06.05.2025, ishte planifikuar zhvillimi i seancës së Komisionit të Disiplinës, i përbërë nga 7 anëtarë. Në vend që ky proces të zhvillohej në mënyrë të rregullt, në respekt të etikës institucionale dhe konfidencialitetit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, ndodhi një situatë e paprecedentë dhe thellësisht e papërshtatshme, veprim diskriminues dhe denigrues që cenon statusin profesional të mësueses M.D.

Në korridorin e shkollës, menjëherë pas një njoftimi të bërë në grupin e WhatsApp-it të mësuesve, 6 maj ora 13:17 nga kolegia E. L antare e Komisionit të Disiplinës, u mbledh shumica e stafit mësues – jo si pjesë e komisionit disiplinor – me qëllim për të kundërshtuar prezencën e një avokati që përfaqësonte mësuesen në këtë proces. Të tre drejtuesit e institucionit ishin prezent gjatë këtij tubimi informal dhe publik, por nuk morën asnjë masë për ta ndaluar, qetësuar apo për ta vendosur procesin në rrugë institucionale dhe të përmbajtur, ashtu siç kërkon ligji.

Në këtë mënyrë, jo vetëm që u shkel e drejta për përfaqësim ligjor, por u cenua rëndë konfidencialiteti i një procesi disiplinor që sipas rregullores dhe ligjit, duhej të zhvillohej vetëm me praninë e anëtarëve të komisionit dhe palës së interesuar, dhe jo në sy të gjithë kolektivit. (si përfaqësuese ligjore largohem nga institucioni sepse e pashë të pamundur vijushmërinë).

Më datë 07.05.2025, nëpërmjet një e-maili nga drejtuesja e Shkollës u konfirmua zyrtarisht se mësuesja M.D mund të përfaqësohej me përfaqësuesin e saj ligjor (avokate) në seancën e Komisionit të Disiplinës (KD), e planifikuar për datën 08.05.2025.

Në seancë u paraqitën pala paditese dhe avokatja, por gjithashtu ishin të pranishëm edhe prindi O. T, mësuesi E. Ç dhe SHPS– të gjithë në cilësinë e subjekteve ankuese.

Në datën 08.05.2025, Komisioni i Disiplinës nuk respektoi rregullat bazë të një procesi të drejtë dhe të paanshëm, në përputhje me Kodit të Procedurës Administrative dhe Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, pasi: Në vend që të shqyrtonte në mënyrë të qetë dhe të pavarur propozimin disiplinor të ardhur nga Komisioni i Etikës, dhe në vend që të thërriste vetëm personin ndaj të cilit drejtohej procedura (mësuesen) për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur mbrojtjen e saj, Komisioni i Disiplinës thirri në mënyrë kolektive edhe personat që ishin pale në konflikt dhe subjektet që kishin dorëzuar ankesat ndaj saj, duke i mbledhur të gjithë bashkë në të njëjtën seancë dëgjimore.

Është shumë e rëndësishme që të theksojmë se ky Komision ishte së pari i paqartë në mënyrë e tij të funksionit dhe gjithashtu për të drejtuar në mënyrë të tillë që të ishte i barabartë me palët. Komisioni kundërshtonte pa baza ligjore prezencën e mësueses me avokat. Vetë drejtuesja e komisionit njofton palën që mund të marrë pjesë në komision me përfaqësues ligjor dhe po kjo drejtuese pohon që nga ZVA me anë të komunikimi me telefon, i kanë pohuar të drejtën që ka pala të jetë me avokat dhe ky komision nuk ishte në gjendje të zhvillonte seancën e tij, pasi antarja e KD D. S kundërshtonte në mënyrë vazhdueshme prezencën e përfaqësuesit ligjor. E gjithë kjo situatë e pazakontë shkaktoi largimin tonë e cila u be pasi u larguan te paret ankuesit dhe zhvillimin e seancës në mungesë.

Seancat e tjera janë zhvilluar pa praninë e palës paditese dhe pa u njoftuar ne lidhje me to. Ndaj vendimit të KD nr. 47, datë 14.05.2025 “Paralajmërim për largim nga puna”, i cili ju njoftua në datën 20.05.2025 u ushtrua e drejta e ankimit administrative pranë DAR Tiranë, brenda afateve dhe procedurës ligjore e dërguar me shërbim postar datë 26.05.2025.

Ky institucion në datën 25.06.2025 (ditën që i është komunikuar largimi nga puna nga Institucioni Arsimor ankueses) i ka kthyer përgjigje me e-mail, jo me shkresë zyrtare, ku relaton se kanë një vendimarrje të drejte sipas tyre.

Pas kësaj date ankimimi 25.06.2025 rifilloi sërish një seri ankesash dhe situatash artificiale të krijuara qëllimisht, pa mbështetje faktike apo profesionale. Këto veprime u shoqëruan me tendencën për të provokuar incidente të sajura ose për të interpretuar në mënyrë të qëllimshme çdo situatë të zakonshme mësimore si problem disiplinor, duke ndërtuar gradualisht një dosje me qëllim penalizimi të mëtejshëm.

Më datë 28.05.2025, duke parë qartazi drejtimin e padrejtë që kishte marrë situata dhe veprimet e koordinuara që po zhvilloheshin në mënyrë të njëanshme ndaj mësueses, iu drejtuam me kërkesë

formale institucioneve të arsimit, përfshirë edhe IA me qëllim që të ndërmerreshin masa për të ndalur përshkallëzimin e situatës dhe për të garantuar një klimë të shëndetshme në institucion. Në këtë kërkesë u theksua nevoja për të shmangur veprime të mëtejshme që mund të çonin në një masë ekstreme si largimi nga puna, pa bazë të drejtë dhe në kundërshtim me procedurat. Fatkeqësisht, kjo kërkesë nuk u mor parasysh. Përkundrazi, situata u përkeqësua më tej, me ngritjen e ankesave të tjera dhe të komisioneve të etikës dhe disipline, si vijon:

Më datë 05.06.2025, ankuesja është lajmëruar në mënyrë të menjëhershme, në rrugë elektronike, se po atë ditë do zhvillohej një seancë e re në Komisionin e Etikës (KE), por pa u njohur paraprakisht me ankesat dhe provat në rrugë shkresore. Nuk i është dorëzuar asnjë shkresë zyrtare për t'u vënë në dijeni të këtyre pretendimeve dhe as për të ti dhënë kohë për të përgatitur mbrojtjen e saj, siç parashikon ligji.

E gjithë kjo ndodhi brenda një afati shumë të shkurtër kohor, ku ishte objektivisht e pamundur të përgatitej për një proces të drejtë disiplinor, për më tepër në një periudhë të ngarkuar profesionalisht, kur ishte e angazhuar me testime, korrigjime, hedhjen e të dhënave në SMIP dhe detyrime të tjera mësimore.

Më datë 09.06.2025, në mënyrë jo transparente dhe me qëllim evident për përshpejtim procedural, u komunikua përmes e-mailit nga KE se ishte bërë një seancë pa praninë e palëve dhe kishin propozuar masë "Largim nga puna" dhe vetëm pak minuta më vonë, një tjetër e-mail nga drejtoresha E. Xh që njoftonte zhvillimin e seancës në Komisionin e Disiplinës më datë 11.06.2025.

Ankuesja nuk është njohur me ankesat, provat dhe faktet. Më datë 11.06.2025 ndodhi një ngjarje e paprecedentë në ambientet e shkollës: Pa asnjë njoftim paraprak me shkrim, ankueses i është komunikuar në mënyrë të menjëhershme dhe joformale që testi i gjuhës italiane për klasën VI-C do të zhvillohej në prezencën e një komisioni prej katër personash, duke i kërkuar të largohej nga zhvillimi i testit, ndonëse ajo ishte mësuesja përgjegjëse për atë lëndë.

Në një moment tensioni të krijuar nga nëndrejtoresha A. C e cila i është drejtuar me tone të larta afër fytyrës, djali i saj i mitur ndërhyri për ta mbrojtur, gjë që i shkaktoi frikë të justifikuar dhe traumë emocionale, si dhe krijoi një ambient të pasigurt emocionalisht për palen paditese dhe fëmijën.

Pa asnjë bazë ligjore apo urdhër me shkrim, i ndalohet ndërveprimi me nxënësit gjatë testit dhe nuk i lejohet të përmbush detyrën e saj si mësuese lëndore, duke e përjashtuar praktikisht nga funksioni i saj.

Pas përfundimit të testit, i është kërkuar të dorëzoje testet origjinale, pa urdhër zyrtar dhe pas refuzimit të palës paditëse për t'i dorëzuar, i kërkohet me insistim të bëhet fotokopjimi i tyre në mungesë të çdo procedure të dokumentuar.

E gjendur në një ambient pune jashtë çdo norme profesionale, me ngarkesë të rëndë ankthi të shkaktuar nga presioni i vazhdueshëm institucional dhe kolektiv, me djalin që u friksua së tepërmi dhe kërkonte të largohej, u detyrua të mos merrte pjesë në seancën e Komisionit të Disiplinës, të datës 11.06.2025.

Megjithatë, për të mos lënë pa reagim një proces që po zhvillohej në mënyrë të njëanshme, i ka dorezuar drejtueses së institucionit ankimimin me shkrim kundër masës “Largim nga puna”, megjithëse kjo masë ende nuk ishte formësuar në një dokument zyrtar, por që lexohej qartë nga veprimet e ndërmarra nga stafi drejtues. Drejtuesja atë ditë kishte thirrur dhe prindrit në seancë disiplinore. Kjo nuk qëndron sepse në seancën e KE të ditës së hënë nuk ishin thirrur por thirreshin në seancën e KD që duhet të ishte një vendimarrje në diskrecion.

Fakti që nga fillimi i procedurës deri në largimin nga puna kanë kaluar vetëm 6 ditë, tregon qartazi një qëllim të nxituar dhe të paracaktuar për t’u larguar nga puna, pa i garantuar një mbrojtje reale, efektive, brenda afateve kohore dhe pa presione institucional.

Më datë 16.06.2025, u njoftua në rrugë shkresore për vendimin nr. 50, prot. 247, datë 11.06.2025, me përmbajtjen “Largim nga puna” ku kjo vendimarrje ishte marrë pas disa ankesave që më listoheshin në vendimin e masës. Është e pabesueshme, nga pikëpamja njerëzore dhe administrative, që një mësuese në kushte të tilla të jetë në pozita për të ushtruar presion mbi një strukturë të tërë shkollore, ndërkohë që vetë ndodhej në pozitë të brishtë, pa përfaqësim të rregullt, pa mbështetje institucionale, dhe e angazhuar intensivisht në kujdesin ndaj një fëmije me nevoja të veçanta. Në vend të një procesi të ndershëm dhe të thelluar që do të shqyrtonte në mënyrë reale çështjen e etikës dhe pretendimeve, duket se është ndjekur një logjikë eliminimi, ku çdo veprim i paditëses është interpretuar në mënyrë penalizuese, pavarësisht nga përmbajtja dhe konteksti i orës mësimore.

Edhe këtë vendim e ankimojë në DAR Tirana dhe përsëri kemi një përgjigje elektronike që është ndjekur procedura, pra një vendim administrativ sic duhet të ishte, madje ankesës së masës së dytë ju kthye përgjigje më shpejt se ankimi i parë. Asnjë verifikim të certifikuar por përgjigje ndërinstitutionale të koordinuara

E tronditur nga ky vendim i rëndë, flagrant dhe ekstrem, paditësjë i është drejtuar disa institucioneve shtetërore në rrugë postare, për të kërkuar verifikim të ligjshmërisë së këtij vendimi dhe ndërhyrje në mbrojtje të të drejtave të saj si mësuese, me pozitë të cënueshme (si nënë kryefamiljare, prind i një fëmije me vështirësi në zhvillim).

Si në procedimin e parë të KD ashtu dhe në të dytin paditësjë M.D. ka pasur situatë të tensionuar krijuar nga IA vetëm pak para fillimit të seancës. Ankuesja vendoset qëllimshëm para presionit institucional, pa garantimin e qetësisë, konfidencialitetit dhe etikës së procesit disiplinor, duke e diskriminuar publikisht dhe përjashtuar praktikisht nga funksioni i saj pa bazë ligjore.

Pas procedurës së masave të marra në kundërshtim të hapur me ligjin dhe pa asnjë prove, iu komunikua gjithashtu nisja e procedurës për shpërbërje të njëanshme të marrëdhënies së punës dhe që në datë 20.06.2025 do dëgjohet dhe do i parashtronin arsyet e largimit nga puna. Dëgjesa rezultoi një tjetër komision discipline ku ju bë gjyqi me tone të larta në Drejtorinë e Shkollës.

Në fakt në çdo situatë shqyrtimi apo komunikimi lidhur me çështjet e pretenduara, ankuesja ka qenë gjithmonë e vendosur e vetme përballë 3 drejtuesëve të institucionit, përballë stafit të shkollës

dhe/ose grupit të prindërve, gjë që e bën të gjithë qasjen dhe komunikimin institucional ndaj saj, jo vetëm të njëanshëm, por edhe psikologjikisht të dëmshëm.

Më datë 25.06.2025, përmes një e-maili, u njoftua se ishte larguar nga puna me vendim nr. 61, prot 247/2. Ishte një moment i rëndë dhe absurd pas 15 viteve në arsim – sepse e bëjnë fajtores pa faj, duke i mbështetur akuzat mbi ndjesi, interpretime subjektive dhe jo mbi fakte të verifikuara objektivisht.”

Ankuesja pretendon se, diskriminimi ndaj asaj ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar që nga viti 2024, me paraqitjen e një ankese pranë KMD-së, dhe ka vijuar pa ndërprerje deri në qershor të vitit 2025, kur ndaj saj u mor masa e largimit nga puna.

Ankuesja ka kundërshtuar gjyqësisht të gjitha masat e mësipërme disiplinore të ndërmarra karshi saj, përfshirë dhe largimin nga puna, dhe, shprehet se aktualisht çështja është në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër të tjera, *konstatimin e diskriminimit në formën e hakmarrjes, për shkak të përfshirjes së saj në procedura pranë KMD-së, si dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës duke e rikthyer në punë.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, është dhe kërkesë-padia e ankueses, si dhe Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me paditës: subjektin ankues, znj. M. D dhe subjekte të paditura, ish-punëdhënësin, shkollën 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë dhe Zyrën vendore Arsimore Tiranë.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të vendimit nr. 4368, datë 02.12.2025, të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, për shkaqet e pretenduara, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, dhe se Gjykata ka disponuar lidhur me to.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe të elaboruara që bëhen prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës dhe në analizimin e disponimin e kësaj të fundit lidhur me to, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë drejtuar Gjykatës, ankuesja kërkon ndër të tjera³:

- “Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit nr. 61, datë 25.06.2025, të Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë, për “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”.
- Rikthimin e paditëses në vendin e saj të punës si mësuese e gjuhës italiane pranë Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë.
- Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit nr. 47, datë 14.05.2025, të Komisionit të Disiplinës, të Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë, për dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”.
- Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit nr. 50, datë 11.06.2025, të Komisionit të Disiplinës, të Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna”.

Gjatë parashtrimeve në kërkesë-padinë e ankueses drejtuar Gjykatës, citohet, ndër të tjera, se⁴:

...Më datë 06.05.2025, ishte planifikuar zhvillimi i seancës së Komisionit të Disiplinës, i përbërë nga 7 anëtarë. Në vend që ky proces të zhvillohej në mënyrë të rregullt, në respekt të etikës institucionale dhe konfidencialitetit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, ndodhi një situatë e paprecedentë dhe thellësisht e papërshtatshme, veprim diskriminues dhe denigrues që cënon statusin profesional të mësueses M.D. rifilloi sërish një seri ankesash dhe situatash artificiale të krijuara qëllimisht, pa mbështetje faktike apo profesionale. Këto veprime u shoqëruan me tendencën për të provokuar incidente të sajura ose për të interpretuar në mënyrë të qëllimshme çdo situatë të zakonshme mësimore si problem disiplinor, duke ndërtuar gradualisht një dosje me qëllim penalizimi të mëtejshëm.

³ “Objekti”

⁴ Respektivisht në faqet 4, 6, 8, 17, 20 dhe 27, të kërkesë-padisë.

... Më datë 28.05.2025, duke parë qartazi drejtimin e padrejtë që kishte marrë situata dhe veprimet e koordinuara që po zhvilloheshin në mënyrë të njëanshme ndaj mësueses, iu drejtuam me kërkesë formale institucioneve të arsimit, përfshirë edhe IA me qëllim që të ndërmerreshin masa për të ndalur përshkallëzimin e situatës dhe për të garantuar një klimë të shëndetshme në institucion. Në këtë kërkesë u theksua nevoja për të shmangur veprime të mëtejshme që mund të çonin në një masë ekstreme si largimi nga puna, pa bazë të drejtë dhe në kundërshtim me procedurat. Fatkeqësisht, kjo kërkesë nuk u mor parasysh. Përkundrazi, situata u përkeqësua më tej, me ngritjen e ankesave të tjera dhe të komisioneve të etikës dhe disipline.

...Më datë 16.06.2025, u njoftua në rrugë shkresore për vendimin nr. 50, prot. 247, datë 11.06.2025, me përmbajtjen "Largim nga puna" ku kjo vendimarrje ishte marrë pas disa ankesave që më listoheshin në vendimin e masës. Është e pabesueshme, nga pikëpamja njerëzore dhe administrative, që një mësuese në kushte të tilla të jetë në pozita për të ushtruar presion mbi një strukturë të tërë shkollore, ndërkohë që vetë ndodhej në pozitë të brishtë, pa përfaqësim të rregullt, pa mbështetje institucionale, dhe e angazhuar intensivisht në kujdesin ndaj një fëmije me nevojë të veçanta. Në vend të një procesi të ndershëm dhe të thelluar që do të shqyrtonte në mënyrë reale çështjen e etikës dhe pretendimeve, duket se është ndjekur një logjikë eliminimi, ku çdo veprim i paditëses është interpretuar në mënyrë penalizuese, pavarësisht nga përmbajtja dhe konteksti i orës mësimore.

...E tronditur nga ky vendim i rëndë, flagrant dhe ekstrem, paditësjë i është drejtuar disa institucioneve shtetërore në rrugë postare, për të kërkuar verifikim të ligjshmërisë së këtij vendimi dhe ndërhyrje në mbrojtje të të drejtave të saj si mësuese, me pozitë të cënueshme (si nënë kryefamiljare, prind i një fëmije me vështirësi në zhvillim

...Fakti që është përballur me një vëllim joproporcional shkresash dhe ankesash, shpesh me përmbajtje të dobët provuese dhe në një afat të shkurtër kohor, dëshmon një klimë të ngarkuar negativisht dhe cënuese për integritetin profesional dhe psikologjik të palës paditëse.

Stafi pedagogjik i ciklit të mesëm të ulët, me të cilin ka bashkëpunuar për shumë vite, ndaloi çdo komunikim me të pasi doli vendimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ky ndryshim i menjëhershëm dhe i koordinuar në sjelljen e tyre nuk kishte asnjë bazë profesionale dhe krijoi një ndjesi të qartë izolimi, përjashtimi dhe presioni të vazhdueshëm për t'u larguar nga pozicioni i saj.

...Theksojmë gjithashtu se anëtarët e Komisioneve Disiplinore për vitet 2023 dhe 2024, të cilët vazhdojnë të jenë pjesë e komisionit edhe në vitin 2025 dhe kanë marrë vendime kundër saj, janë të njëjtat kolege: znj. D. S, znj. E. L, znj. A. C dhe znj. L. Gj.

Në mënyrë të përsëritur, këto anëtare kanë dhënë vendime që janë konstatuar me shkelje të rënda edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e palës paditëse për një proces të rregullt ligjor dhe për të mbrojtur dinjitetin e saj profesional dhe personal.

...Pasi kërkoi përshtatjen e arsyeshme të orarit dhe ju drejtua Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u bë pre e hakmarrjes.

...Fakt: Vetëm pasi paditësja bën kërkesë legjitime për përshtatjen e arsyeshme të orarit, nisin masat ndëshkuese. Vetëm pasi i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku ankoni sjelljen e padrejtë të institucionit, merr “largim nga puna”, pas 15 viteve në arsim.”

Lidhur me sa më sipër pretenduar nga pala paditëse, znj. M. D, Gjykata me vendimin nr. 4368, datë 02.12.2025, ka disponuar me rrëzimin e kërkesë-padisë.

Në arsyetimin e saj, lidhur me kërkimet e ankueses, Gjykata, ndër të tjera, shprehet se⁵:

“...Gjykata i gjen të pabazuara në ligj dhe prova pretendimet e paditëses...

...Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e ankueses se, ajo, ka pasur klimë armiqësore në kolektiv mbas Vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kolegët e paditëses kanë ndërprerë çdo komunikim me të, duke krijuar izolim profesional, presion psikologjik, diskriminim indirekt, synim të qartë për ta larguar nga puna.

Në bazë të akteve shkresore rezulton se paditësja me sjelljen dhe veprimet e saj të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së mësueses dhe të prindit ka krijuar klimë të papërshtatshme me kolegët e saj, nxënësit dhe prindërit e shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë. Në seancë gjyqësore nuk u provua ekzistenca e rasteve të diskriminimit të paditëses, të parashikuara në nenin 9, të Kodit të Punës.

...Vendimet e KE dhe KD janë marrë duke respektuar procedurën administrative të përcaktuar në ligjin mbi arsimin parauniversitar dhe akteve nënligjore të tyre. Janë të arsyetuara, tregojnë shkëlqet ligjore të kryera nga paditësja, aktet shkresore ku ato janë bazuar në përcaktimin e shkëlqes ligjore, përpara se të merrën aktet administrative nga KE dhe KD. I është krijuar mundësia paditëses për t’u dëgjuar dhe për t’u njohur me ankesat, procesverbalët dhe përfundimet e nxjerra nga këto organe. I është krijuar mundësia paditëses t’i kundërshtojë ato dhe të paraqesë kundërshtime rreth tyre. Aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor janë të bazuara në ligjin material të arsimit parauniversitar dhe aktet nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Në seancë gjyqësore nuk u provua ekzistenca e paligjshmërisë së akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor.

Gjykata si shqyrtoi aktet shkresore, dëgjoi palët ndërgjyqëse, çmon se masa disiplinore (objekt shqyrtimi gjyqësor) dhënë paditëses është bërë proporcion me shkëlqen e kryer dhe për këtë fakt, diskrecioni nga pala e paditur është ushtruar i ligjshëm. U provuan në seancë gjyqësore, shkëlqet e rënda dhe të përsëritura të kryera nga paditësja dhe se me të drejtë pala e paditur ka marrë masën “Largim nga puna” dhe se çdo masë tjetër ishte e papërshtatshme për paditësen.

...Gjykata çmon se veprimet e punëmarrëses M. D kanë shkaktuar humbjen e plotë të besimit ndërmjet saj dhe punëdhënësit, Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Osman Myderizi”...

⁵ Shih faqen 32-34, të Vendimit nr. 4368, datë 02.12.2025, të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Përfundimisht, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesë-padia është e pabazuar në ligj e prova dhe si e tillë duhet të rrëzohet...”

Bazuar në analizën e disponimet e bëra nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në vendimin me nr. 4368, datë 02.12.2025, të saj, ajo *inter alia*, është shprehur lidhur me pretendimet e ankueses për trajtim të padrejtë e diskriminues, duke disponuar se ndaj saj nuk ka pasur veprime diskriminuese për shkaqet e pretenduara, në formën e hakmarrjes ndaj saj për shkak të ankimimit tek KMD. Ankuesja ka investuar kështu edhe Gjykatën, për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Ankuesja është shprehur se vendimin sa më sipër e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këtë kuptim, shqyrtimi i pretendimeve të saj vijon të jetë në proces të shqyrtimit gjyqësor, në Gjykatën e Apelit Administrativ, vendim i së cilës është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkaku ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njëzuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njëzuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në*

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: “Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata⁶, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 45 Regj., datë 11.02.2026, të znj. M. D, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj⁷.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁸, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

⁶ Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë.

⁷ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021; nr. 27, datë 16.02.2021; nr. 77, datë 07.05.2021; nr. 230, datë 25.11.2021; nr. 253, datë 28.12.2021; nr. 77, datë 21.04.2022; nr. 108, datë 20.06.2023; nr. 145, datë 26.07.2023; nr. 89, datë 03.04.2024; nr. 25, datë 30.01.2025; nr. 269, datë 26.11.2025, të Komisionerit.

⁸ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 45 Regj., datë 11.02.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, M. D, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA